

Trajtimi financiar i Policisë së Shtetit

SOT

- Pagat e mbi 11 mijë punonjësve të policisë rriten përsëri këtë Mars
- Pagat e punonjësve të Policisë të nivelit bazë rriten me rreth **17%** ose në vlerë absolute **10.070 lekë të reja**. Paga e inspektorit në vitin 2017 bëhet 69 mijë lekë, pra rritet **45% krahasuar me vitin 2013**.

DJE

- Rritja e fundit e pagave për punonjësit e Policisë së Shtetit datonte në vitin 2003.
- Madje atëherë paga kishte ardhur duke u ulur, dhe paga neto e punonjësit të policisë më shumë ishte ulur në vitin 2011, me 4%.
- Në vitet 2005 deri 2013 Policia e Shtetit ishte më e keqtrajtuara financiarisht. Një punonjës policie, për krahasim, paguhej 34% më pak se punonjësit e tjerë të administratës publike.

PAS 2013

- Vendimi i Qeverisë për taksën progresive ndikoi menjëherë për rritjen e pagës neto për punonjësit e policisë, veçanërisht për punonjësit e policisë të nivelit bazë. Dhe paga u rrit vetëm për këtë shkak me 2.3 %, ndërsa pagat e nivelit bazë u rrit me 5%.
- Gjatë vitit 2014, u rritën pagat me 25% për punonjësit e Policisë së Shtetit, paga e punonjësit të policisë të nivelit bazë nga 45.600 lekë u bë 57.100 lekë.

ÇFARË TJETËR?

- Me Ligjin e ri të Policisë së Shtetit u parashikua rritja e pagës për efekt të vjetërsisë në punë, dhe kjo fillon që në mars të këtij viti. Kjo sjell përsëri një **shtesë me 5%** në pagat e punonjësve të policisë.

- Është miratuar një tjetër VKM, dje, për dhënie ndihme menjëhershme financiare, punonjësit të Policisë, në rast dëmtimi të rëndë të pronës për shkak të detyrës, në masën 100% të vlerës.
- Miratuar ligjin “Për sigurimin shëndetësor të veçantë të punonjësve të strukturave Speciale Operacionale të Policisë së Shtetit”.
- Shlyem të gjitha detyrimet e prapambetura për punonjësit e Policisë së Shtetit në masën 2.2 milion euro, që qeveria e kaluar i kishte borxh punonjësve të policisë.
- Është në qeveri dhe pritet miratimi së shpejti, projektligji për dhënien e kredive të buta, ku përfshihen forcat RENEA.